

KONTRATE E THEMELIMIT  
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"EMKO" SHPK



Neni 1

Une Shaelda Mema, e datlindjes 30.06.1979 , e lindur ne Fier dhe banuese ne adresen Unaza e Re Tirane , me vullnet te lire e te plote, sot me date 24.01.2006 krijova shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "EMKO" SHPK .

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, "Unaza e Re" (100 m nga Rruga e Kavajes) . Me vendim te ortakcs se vetme mund te hapen, agjensi, filiale, dege brenda territorit te Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete 10 vjet dhe do te filloi nga momenti i regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane.

Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Prodhim dhe montim te pajisjeve dhe orendive per zyra, insitucione social kulturore dhe banuesa, prej druri dhe metalike, tregtim me shumice dhe pakice, importin dhe eksportin si dhe lenden e pare per prodhimin .Tregtim me shumice e pakice te te gjitha artikujve industrial, ushqimore, konfeksione, kinkaleri, elektroshtepiake, hirdosaniatre, materiale ndertimi, materiale druri, dyer te blinduara e te presuara, tjegulla, lende drusore dhe aksesore te drurit, mokete, hekur per ndertim , metale te llojeve te ndryshme, skrape.Import-eksport i ketyre artikujve.Veprimtari imobilare, shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Ndermjetesim per dhenie me qira te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Transport mallrash .

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakes se vetme SHAELDA MEMA , e cila ka ne pronesi 100 % te kapitalit te shoqerise.

Neni 6

Mbi bazen e kontributit ne kapital edhe fitimi i realizuar gjate veprimtarise se shoqerise mbetet prone e ortakes se vetme .

Neni 7

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private ose shtetore.

Neni 8

Per nevoja te punes kjo shoqeri do te punesoje edhe punëtore e specialiste te ndryshem me kontrate te rregullt pune sipas ligjeve ne fuqi.


Neni 9

Administratore e shoqerise eshte ortakja e vetme Shaelda Mema .

Neni 10

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj. Kontrata e themelimit u perpilua ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKE E VETME  
E SHOQERISE "EMKO" SHPK  
SHAELDA MEMA



**STATUTI**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"EMKO" SH.P.K**



**FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA**

**Neni 1**

Une Shaelida Mema ortake e vetme , ne daten 24.01.2006, kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " **EMKO**" sh.p.k.

**Neni 2**

Shoqeria eshte formuar sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik fillon me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane.

**Neni 3**

Shoqeria e ka seline ne Tirane, " Unaza e Re" ( 100 m nga Rruga e Kavajes). Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj me vendim te ortakes se vetme .

**Neni 4**

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj ne teritorin e Republikes se Shqiperise.

**FUSHA E AUTORITETIT TE PALEVE**

**Neni 5**

Fusha e autoritetit te ortakut, perqindja e fitimeve ose e humbjeve, kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve do te kene si kriter baze kapitalin e shoqerise.

## LIBRI I SHOQERISE

### Neni 6

Per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe mardheniet e punes, shoqeria do te mbaje gjithë dokumentacionin ligjor e financiar.

## OBJEKTI

### Neni 7

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Prodhim dhe montim te pajisjeve dhe orendive per zyra, insitucione social kulturore dhe banuesa, prej druri dhe metalike, tregtim me shumice dhe pakice, importin dhe eksportin si dhe lenden e pare per prodhimin .Tregtim me shumice e pakice te te gjitha artikujve industrial, ushqimore, konfeksione, kinkalери, elektroshtepiake, hirdosaniatre, materiale ndertimi, materiale druri, dyer te blinduara e te presuara, tjegulla, lende drusore dhe aksesore te drurit, mokete, hekur per ndertim , metale te llojeve te ndryshme, skrape.Import-eksport i ketyre artikujve.Veprimtari imobilare, shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Ndermjetesim per dhenie me qira te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Transport mallrash .

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

### Neni 8

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates shkalles pare Tirane.

## KAPITALI THEMELTAR

### Neni 9

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke i depozituar per llogari te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " **EMKO** " dhe eshte pronesi 100% e ortakes se vetme .

## LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

### Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme tek personat e trete ne qofte se vendos per kete ortakja e vetme e shoqerise . Gjitheashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashgimie.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 11

Shoqeria mund te hape filiale, dege, agjensi ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne permbushjen e qellimit te saj ne te gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 12

Organe drejtues te shoqerise jane si me poshte:

1. ~~Vendimet e~~ Ortakës e Vetme ,
2. Administratori .

## LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

### Neni 13

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje dokumentacionin kontabel. Librin e shoqerise ne te cilin shenohen emri i plote i shoqerise, ortakët, kapitali themeltar si dhe vendimet qe merr ortakja e vetme .

### Neni 14

Bilanci financiar mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel miratohen nga ortakja e vetme.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

### Neni 15

Ortakja e vetme nepermjet vendimeve qe merr realizon te gjithë veprimtarine e shoqerise. Ajo percakton drejtimet kryesore te veprimtarise, vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, ne aktin e themelimit, per shimin e kapitalit, per pranimin ne shoqeri te ortakeve te tjere, te gjitha keto ne zbatim te ligjit per shoqerite tregtare. Ortakja e vetme vendos per fuqine puntore, per pagat e tyre duke lidhur kontrata me ta sipas marreveshjes se dyanshme, ne perputhje me ligjet shqiptare.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe ortakja e saj merr persiper si person fizik tej veprimtarise se shoqerise .

### Neni 16

Administratorja e shoqerise lidh kontrata me persona fizik e juridik, shtetror vendas e te huaj si dhe ndjek drejtimet e aktivitetit te shoqerise.

Levizjet e depozites ne banke do te behen me nenshkrimin e administratores dhe ne mungese, me prokure te leshuar prej saj, ka te drejte te kryeje veprime cdo person tjeter .

Administratori ka te drejte qe per llogari te shoqerise te marre kredi ne banke, duke pergatitur dhe nenshkruar te gjithë dokumentacionin e nevojshem per kete qellim.

### Neni 17

Ortakja e vetme ka te drejte te emeroje ekonomiste dhe avokate si dhe tu jap te drejte personave te trete qe te veprojne ne emer e per llogari te saj me autorizim ose prokure, ne perputhje te plote me ligjin shqiptar.

### Neni 18

Shperndarja e shoqerise mund te vije per çdo aresye, ortakja e vetme vendos menyren e likujdimit duke caktuar nje ose disa likujdatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo u ka personave fizik e juridik te trete.

Neni 19

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "EMKO " SH.P.K. Tirane,  
Albania.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 20

Persa nuk eshte shkruar ne kete statut gjate veprimtarise se shoqerise do te behen plotesime me vendim te ortakes se vetme sipas ligjeve ne fuqi per shoqerite tregtare.

Neni 21

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te linden gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do ti paraqiten per zgjidhje gjykates rrethit gjyqsor Tirane.

Neni 22

Ky statut eshte hartuar ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKE E VETME  
E SHOQERISE "EMKO" SHPK  
SHAELDA MEMA

